

NE, POPULLI



MARRIM VENDIME

FUQIA ËSHTË E POPULLIT

ILMI (11), ERON (11), BESJAN (11), FLORENTINA (11), RIGA (10), AGNESA (12)

Pa demokraci



Me demokraci



Të drejtat tona në demokraci

Secili njeri duhet ta ketë lirinë dhe të drejtat e barabarta me të tjerët. Kush na i mundëson këto të drejta? Demokracia është formë e qeverisjes, e cila na mundëson pikërisht të drejtat tona.


Forma e parë e demokracisë u shfaq në Athinën e Greqisë së lashtë, në vitin 507 para erës sonë. Atëherë vendimet janë marrë vetëm nga burrat e pasur, kurse gratë dhe skllëvërit nuk kanë pasur të drejtë të marrin vendime dhe të shprehin mendimet e tyre. Por, me kalimin e kohës kanë ndodhur shumë ndryshime dhe tashmë të gjithë kemi të drejta të barabarta.

Janë dy forma të demokracisë: demokracia e drejt-përdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Demokracia përfaqësuese i ka dy sisteme: sistemin parlamentar dhe atë presidencial. Shteti ynë Kosova është vend demokratik me sistem parlamentar, sepse populli në zgjedhje voton kandidatët për deputetë.

Ne shkojmë në shkollë dhe mësojmë gjëra të ndryshme, sepse ne gëzojmë të drejtën për t'u shkolluar. Gjithashtu, ne lozim me fëmijë të tjerë në lagjen në të cilën jetojmë, pasi që demokracia na mundëson të drejtën e lojës. Secili njeri pëlqen profesione të ndryshme, për shembull: mësues/e, mjek/e, arkitekt/e, sportist/e, ushtarë/e, gjykatës/e, etj. Në të ardhmen, ne mund ta zgjedhim profesionin që dëshirojmë, sepse ne jemi të lirë ta bëjmë këtë zgjedhje. Pra, në demokraci ne jemi të lirë të shprehim mendi-

met dhe dëshirat tona.


Të dashur lexues, shpresojmë që ky artikull ju ka pëlqyer dhe besojmë që e keni kuptuar se demokracia është forma e duhur e qeverisjes për një vend.



E drejta e shkollimit



Grupi „Dituria“




Të gjithë e kemi të drejtën e votës që nga moshën 18 vjeçare




Florentina duke bashkëpunuar me Rigën



Të punojmë së bashku, sepse kështu do të kemi rezultate më të mira



E drejta e lojës



Voto për të ndryshuar. Vota juaj ka vlerë



Punuar me përkushtim për konceptet e demokracisë

DETYRAT E KUVENDIT

LUNDRIM (11), HAJREDIN (11), ANITA V. (11), ERIOLA (10), ANITA I. (11)

FUNKSIONET E KUVENDIT TË KOSOYES




Ne kemi vendosur që të shkruajmë për Kuvendin e Kosovës dhe ju ftojmë që ta lexoni këtë artikull të shkruar nga ne

Ne kemi rregulla të ndryshme, si në shkollë ashtu edhe në shtëpi, në komunikacion, etj. Të fillojmë prej rregullave të shkollës, të cilave duhet t'i u përmbahemi. Mësuesja jonë na ka treguar për shumë rregulla të shkollës. Ne duhet të dëgjojmë mësuesen dhe shokët tanë kur flasin, të jemi të pastër dhe të mbajmë klasën e pastër. Të gjithë ne i respektojmë këto rregulla. Në shtëpi kemi rregull t'i dëgjojmë prindërit, të mos i prekim gjërat me elektricitet dhe zjarr. Ndërsa, në rrugë duhet t'i respektojmë shenjat e komunikacionit dhe këmbësorët e tjerë, sepse ekzistojnë ligje të krijuara nga shteti për këtë aspekt. Ligjet janë rregulla të shkruara, të cilat nxirren nga Kuvendi i Kosovës. Disa nga ligjet janë: ligjet për arsim, ligjet për shëndetësi, ligjet për komunikacion, etj. Njëri nga ligjet thotë se

çdo fëmijë duhet të shkojë në shkollë dhe duhet ta përfundojë shkollën fillore dhe të mesme të ulët. Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë, të cilët zgjedhen nga votat e qytetarëve. 100 deputetë janë shqiptarë, 10 janë serbë dhe 10 janë ashkali, romë, boshnjakë, turq, goranë dhe egjiptianë. Disa nga detyrat e Kuvendit janë: të zgjedh Kryetarin e Kuvendit, Kryeministrin, Presidentin dhe të miratojë ose të mos miratojë ligje. Takimet e deputetëve quhen seanca plenare. Këto seanca mbahen në ditën e enjte dhe aty janë të pranishëm edhe Kryeministri dhe ministrat. Ne gjithashtu mësuam për funksionet e Kuvendit të Kosovës, të cilat janë: funksioni përfaqësues, funksioni legjislativ dhe funksioni i kontrollit. Ashtu si deputetët, edhe ne në klasë zgjedhim kryetarin e klasës sonë, i cili ka përgjegjësi ta udhëheq klasën dhe t'i përkrah të gjithë nxënësit e klasës. Ne ju falenderojmë që lexuat artikullin tonë për Kuvendin e Kosovës.




Autorët e artikullit që po e lexoni



Këto janë rregullat që duhet t'i respektojmë

QYTETAR I MIRË ËSHTË QYTETARI AKTIV

XHENETA (11), NAZLIJE (11), ENES (11), EDONA (11), ORGEST (10), ARDIANA (11)



Nëse dëshironi të mësoni edhe ju pak nga ajo çka ne kemi mësuar, lexojeni artikullin tonë më poshtë

Qytetarë jemi të gjithë ne, të cilët jetojmë në një shtet. Por, ne duhet të dimë se në demokraci të gjithë i kemi të drejtat tonat, të cilat na e lehtësojnë jetën tonë. Këto të drejta janë: e drejta për të folur lirshëm, e drejta e shkollimit, e drejta për të votuar, e drejta për të pasur pronë, e drejta për të punuar, e drejta për formimin e familjes, e drejta e argëtimit, etj. Edhe pse ne të gjithë kemi të drejta, kjo nuk do të thotë se nuk kemi përgjegjësi. Sa herë të tjerët na këshillojnë, ne duhet t'i dëgjojmë ata.

Sot, kur mësuesja jonë na këshilloi që të mos bëjmë zhurmë dhe të sillemi mirë kur të vijmë këtu në Punëtorinë e Demokracisë, ne e morëm si përgjegjësi këshillën e mësuesës sonë dhe e zbatuam atë gjatë gjithë kohës.

Për të qenë qytetarë të mirë ne duhet të jemi aktiv duke marrë pjesë në organizata të ndryshme, të cilat na mësojnë për demokracinë, siç është projekti „Demos-ti“ e shumë projekte të tjera me qëllime të mira. Një mënyrë e mirë për t'u bërë qytetarë aktiv është mbledhja e shisheve të plastikës në ambientin shkollor dhe ato shishe t'i dërgojmë në vendin ku reciklohen plastikat. Më pas me paratë që ne i marrim, ne mund të blejmë libra të ndryshëm dhe kështu mund ta pasurojmë bibliotekën e shkollës sonë.

Ne i këshillojmë të gjithë qytetarët e tjerë që të jenë pjesëmarrës në organizata të ndryshme dhe të marrin iniciativa për të pastruar ambientet publike. Kjo na bën që në të njëjtën kohë të jemi qytetarë aktiv, por edhe të kemi jetë të shëndetshme.



Grupi „Qytetaria Aktive“



Të bëhemi qytetarë aktiv



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Dëshmorët e Kombit“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Kamenicë